VENDIM
Nr. 157, datë 17.6.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË *"ALBANIAN GREEN ENERGY"* SHPK, ME NR. 372 SERIA F12/17, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d", nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 925 prot., datë 14.6.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë *'Albanian Green Energy'* sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhe relacionin nr. 925-1 prot., datë 16.6.2022, "Relacion shtesë mbi rinovimin e licencës së shoqërisë *'Albanian Green Energy'* sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 100, datë 9.5.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë *"Albanian Green Energy"* sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/16 prot., datë 10.5.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës dhe me shkresën nr. 577/1 prot., datë 13.5.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me "Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar".

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.5.2022), rezultoi të jetë paraqitur në ERE shkresa e datës 15.5.2022, e protokolluar në ERE me nr. 577/2 prot., 17.5.2022 e studios ligjore "Lamaj Law", e cila i drejtohet ERE-s në emër dhe për llogari të Z.V.H., me qëllim për të detyruar shoqërinë *"Albanian Green Energy"* sh.p.k. të përmbushë detyrimin kundrejt ankuesit Z.V.H. përpara rinovimit të licencës së furnizimit me energji elektrike.

- Në kuptim të nenit 20, germa "ë", të ligjit nr. 43/2015, ERE zgjidh mosmarrëveshjet, në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë nga rastet e mosmarrëveshjeve të cituara në ligj, por me detyrime kontraktore/civile që duhet të adresohen pranë organeve përkatëse në zbatim të legjislacionit civil.

- Kërkesa e Studios Ligjore *"Lamaj Law"*, drejtuar ERE-s për të detyruar shoqërinë *"Albanian Green Energy"* sh.p.k. të shlyej detyrimin e mbetur ndaj Z.V.H, nuk është kompetencë e ERE-s dhe nuk afekton vendimmarrjen e saj për rinovimin e licencës së shoqërisë *"Albanian Green Energy"* sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për vetë faktin se aktet të cilave u referohen, përfaqësuesit e Z.V.H. u kanë dhënë zgjidhje edhe modaliteteve të shlyerjes së të gjitha detyrimeve kontraktore.

- Në mbledhjen e datës 17.6.2022 u paraqitën përfaqësuesit e Studios Ligjore *"Lamaj Law"*, të cilët pranuan se nuk kanë qëllim të pengojnë rinovimin e licencës së shoqërisë *"Albanian Green Energy"* sh.p.k., por kërkojnë që ERE të ushtrojë presion pozitiv për shkak të detyrimeve që ka shoqëria ndaj të tretëve.

- Po ashtu, në këtë mbledhje mori pjesë *online* edhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë *"Albanian Green Energy"* sh.p.k., i cili u shpreh se kur ekziston një mosmarrëveshje midis palëve në gjykatë, asnjë institucion nuk mund të shprehet deri në dhënien e një vendimi të formës së prerë nga kjo e fundit.

- ERE, në këtë mbledhje, qartësoi faktin se nuk mund të përdoret si një mjet shtrëngues ndaj aktorëve të tregut energjetik dhe se nuk është në kompetencën e saj zgjidhja e një kërkese të tillë. Në përfundim të diskutimeve u vlerësua se kërkesat/objeksionet e Studios Ligjore "Lamaj Law", nuk afektojnë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë *"Albanian Green Energy"* sh.p.k. dhe dokumentacioni i dorëzuar për këtë procedurë nga shoqëria është në përputhje me "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin.

- Shoqëria *"Albanian Green Energy"* sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 376, seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, që nga data 27.7.2017, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 114, me afat vlefshmërie deri më datë 27.7.2022.

- Në nenin 16, pika 1, e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, përcakton se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 19.4.2022, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të rregullores.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike bazuar në aneksin A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar. Shoqëria *"Albanian Green Energy"* sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 376, seria F17, të shoqërisë *"Albanian Green Energy"* sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.7.2017, të ndryshuar, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 28.7.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti